



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS**

UDHËZIM

PËR FORMËN E NJOFTIMIT TË MARRËVESHJEVE

Në mbështetje të nenit 49, pika 3 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës

UDHËZON

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim përcakton përmbajtjen dhe formën e Formularit të Njoftimit, (bashkëlidhur këtij Udhëzimi) që do të plotësohet nga një ndërmarrje ose grup ndërmarrjesh kur njoftojnë Autoritetin për një marrëveshje. Një “marrëveshje” është përcaktuar në Kreun I, neni 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (tani e më pas do t’i referohemi si “Ligji”)

Neni 2

Përcaktimet dhe udhëzimet në lidhje me Formularin bashkëlidhur

Marrëveshje horizontale: nënkuptojnë ato marrëveshje që lidhen ndërmjet ndërmarrjeve konkurrencte (ndërmjet prodhuesave ose grosistëve) që veprojnë në të njëjtin nivel ekonomik.

Marrëveshje vertikale: nënkuptojnë ato marrëveshje që lidhen ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në nivele të ndryshme tregu (prodhues-shpërndarës).

Pala ose palët që bëjnë njoftimin: në rastet kur një njoftim është paraqitur vetëm nga njëra prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje, “palët që bëjnë njoftimin” përdoret për t’iu referuar vetëm ndërmarrjes që po paraqet faktikisht njoftimin.

Palë(ët) në marrëveshje ose palët: përfshijnë të gjitha ndërmarrjet të cilat u përkasin grupeve të njëjta si këto “palë”.

Tregjet e prekura: Seksioni 3 i këtij Formulari kërkon që palët që bëjnë njoftimin të përcaktojnë tregjet përkatëse të produktit dhe për më tepër të identifikojnë cilët nga këto tregje përkatëse mund të preken nga marrëveshja e njoftuar. Ky përcaktim i tregut të prekur përdoret si bazë e të dhënave të kërkuara për një numër pyetjesh të tjera që përmban ky Formular. Përcaktimet e paraqitura në këtë mënyrë nga palët që bëjnë njoftimin i referohen në këtë Formular si treg(je) të prekura. Ky term i referohet tregut përkatës si për mallrat ashtu edhe për shërbimet, të cilat i përmbledhim në përcaktimin e dhënë në Ligj “treg përkatës” , (neni 3, pika 7).

Tregu përkatës: Përcaktimi i tregut përkatës është një mjet për të identifikuar dhe përcaktuar kufijtë e konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve. Çdo kufizim konkurrence analizohet duke pasur parasysh një treg të caktuar. Në bazë të këtij tregu përcaktohen pjesët e tregut që i takojnë çdo ndërmarrje. *Tregu që merret si bazë në llogaritjen e pjesëve të tregut dhe përcaktimin e kufizimeve të konkurrencës quhet treg përkatës.* Ky përkufizim përfshin dy komponentët e tregut përkatës: *tregu i produktit dhe tregu gjeografik.*

Tregu i produktit: Tregu i produktit përfshin të gjithë mallrat ose shërbimet që konsiderohen të zëvendësueshëm nga konsumatori në sajë të karakteristikave, të çmimit të produkteve dhe të përdorimit që do i bëjnë.

Tregu gjeografik: Tregu gjeografik përfshin në radhë të parë hapsirën tokësore ku tregtohen mallrat që përbëjnë tregun e produkteve. Tregu gjeografik mund të jetë lokal (një qytet apo rreth), kombëtar (Republika e Shqipërisë), ose Europian madje dhe botëror.

Pjesa e tregut: i referohet pjesës së tregut përkatës ku ushtron veprimtarinë e saj ndërmarrja. Për të llogaritur pjesën e tregut mund të bazohemi në xhiron e realizuar për çdo produkt, në sasinë e produkteve të shitura, në numërin e abonentëve ose të klientëve që ka, etj. Llogaritja sipas xhiros së realizuar të çdo produkti është më e përshtatshme, sepse xhiroja reflekton dhe vlerën reale të produktit dhe jep një prezantim më të mirë të vendit që zë produkti në treg.

Fuqia e tregut (market power): nënkupton mundësinë e ndërmarrjes për të praktikuar (aplikuar) çmime më të larta se në situatë konkurrence për një kohë të konsiderueshme dhe të fitojë më shumë se normalisht.

Pengesat në hyrje (barriers to entry): përdoret për të emërtuar vështirësitë e ndryshme që hasin ndërmarrjet për të hyrë në një treg të caktuar.

Konkurrenca potenciale: paraqet mundësinë e konkurrencës dhe presionit konkurrues të ushtruar nga ndërmarrjet ekzistuese (incumbent, or potential competitor) ndaj ndërmarrjeve të reja që duan të futen në një treg specifik.

Vit: të gjitha referencat për fjalën “vit” në këtë formular duhet të lexohen në kuptimin e vitit kalendarik, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe. Të gjitha të dhënat e kërkuara në këtë Formular, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe, duhet të lidhen me vitin pararendës të njoftimit.

Neni 3

Nevoja për një njoftim të saktë dhe të plotë

Të gjitha të dhënat e kërkuara në Formularin e Njoftimit duhet të jenë të plota dhe të sakta. Të dhënat e kërkuara duhet të përfshihet në Seksionin përkatës të këtij Formulari. Dokumentacioni që do të shoqërojë Formularin do të përdoret vetëm për të plotësuar të dhënat e siguruara në Formular.

Në veçanti duhet të bëhet kujdes që:

Në zbatim të neneve 49 dhe 50 të Ligjit, afati kohor lidhur me shqyrtimin e njoftimit, do të fillojë të llogaritet me marrjen e të gjitha të dhënave nga Autoriteti, që duhet të sigurohen nga ndërmarrjet në formularin e njoftimit. Kjo bëhet për të siguruar që Autoriteti të jetë i aftë për të vlerësuar eficientë ekonomike në rastin e dhënies së autorizimit për përjashtim të marrëveshjes nga ndalimi.

Palët që bëjnë njoftimin, gjatë përgatitjes së njoftimit, duhet të bëjnë kujdes që emrat dhe numrat e kontaktit, veçanërisht numrat e faksit, të dërguara pranë Autoritetit të jenë ata të duhurit, pra të jenë të saktë dhe më të fundit.

Nëse njoftimi nuk është i plotë dhe i saktë, Autoriteti do të njoftojë me shkrim brenda 15 ditëve nga momenti i marrjes së njoftimit, palët që bënë njoftimin ose përfaqësuesit e tyre që ta plotësojnë atë. Njoftimi do të jetë i efektshëm vetëm në datën, në të cilën do të merret nga Autoriteti të dhënat e sakta dhe të plota.

Në njoftim, të dhënat jo të sakta, jo të plota ose mashtruese do t'i nënështrohen Ligjit si më poshtë:

Në zbatim të nenit 73, pika 1/a dhe b e Ligjit të dhënat jo të sakta, jo të plota ose mashtruese, mund ta bëjnë palën ose palët që kanë bërë njoftimin përgjegjëse për vendosjen e gjobave deri në masën 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar. Në zbatim të nenit 51, pika 1, shkronja c të Ligjit, Komisioni mund të revokojë ose ndryshojë vendimin e tij lidhur me përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes.

Neni 4

Detyrimi për njoftim

Njoftimi i marrëveshjes sipas nenit 49 të Ligjit duhet të plotësohet nga ndërmarrja (et) palë në marrëveshje.

Në se ndërmarrja (et), autorizon një person për ndjekjen e procedurës, ai duhet të jetë i paisur me autorizimin me shkrim, ku përcaktohet e drejta për përfaqësim.

Nëse njoftimi është i përbashkët, ndërmarrjet duhet të autorizojnë me shkrim vetëm një përfaqësues, që ka të drejtën për të ndjekur procedurën.

Palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre duhet të kenë një adresë në Shqipëri ku mund të dërgohet korespondenca.

Çdo palë që bën njoftimin, është përgjegjëse për saktësinë e të dhënave që sigurohet në të.

Neni 5

Si të njoftohet

Njoftimi për marrëveshjen duhet të plotësohet në gjuhën shqipe.

Të dhënat e kërkuara në Formularin bashkëlidhur duhet të përgatiten duke përdorur numrat e seksioneve dhe paragrafëve të Formularit, duke nënshkruar një deklaratë siç jepet në Seksionin 10, si dhe duke i bashkëlidhur dokumentacionin mbështetës.

Dokumentat bashkëlidhur njoftimit duhet të dorëzohen në gjuhën zyrtare. Nëse gjuha zyrtare nuk është shqip, atëherë, njoftimit i duhet bashkëlidhur një përkthim i noteruar në gjuhën shqipe. Autoriteti mund të kërkojë në çdo kohë përkthimin në shqip të dokumentave bashkëlidhur.

Dokumentat bashkëlidhur njoftimit duhet të përmbajnë të paktën një origjinal ose një kopje të noterizuar të origjinalit. Me kërkesën e Autoritetit palët që bëjnë njoftimin duhet të vërtetojnë që kopjet e tjera janë të vërteta dhe të plota.

Njoftimi duhet të dërgohet pranë Autoritetit në ditët e punës, brenda orarit zyrtar, në adresën në vazhdim:

Autoriteti i Konkurrencës

Rruga “S. Frashëri”, Nr. 4,

Kutia Postale 2435, Tel: 04/23 45 05, Fax: 04/ 23 45 04

e-mail: caal@icc-al.org

www.caa.gov.al

Tiranë, SHQIPËRI

Neni 6

Ruatja e konfidencialitetit dhe sekreteve tregtare

Autoriteti në zbatim të nenit 30 ruan sekretin profesional dhe nuk jep të dhëna konfidenciale lidhur me veprimtarinë e palëve njoftuese.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Zef PREÇI